

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

BULETINI MUJOR

Mars 2021



ILD
INSPEKTORI I LARTË
I DREJTËSISË



BE DO VIJOJË ASISTENCËN TEKNIKE PËR ILD-NË

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani zhvilloi një takim pune me ambasadorin e Bashkimit Evropian në Shqipëri, Z. Luigi Soreca.

Z. Metani bëri një prezantim të punës 13 mujore të zyrës së ILD-së, me sfidat, arritjet e nevojat për përmbushjen e misionit në ndëshkimin e paligjshmërive në sistem, duke inkurajuar standardet më të mira të punës së gjyqtarëve e prokurorëve.

“Përmbushja e pritshmërive të publikut për drejtësinë e re duhet të jetë një përpjekje e përbashkët e të gjitha institucioneve.” – tha Z. Metani.

Mbi takimin me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Z. Metani, ambasadori Soreca postoi në llogarinë e tij në Twitter:

“I lumtur që takova sërish Inspektorin e Lartë të Drejtësisë Artur Metani në ambientet e tij të reja.

E përgëzoja për vitin e parë të punës, përfshirë & komunikimin e mirë me publikun. BE do të vazhdojë të sigurojë asistencë teknike për ILD për të rritur më tej efikasitetin e saj.”



Ankimimi në ILD

Ankesa juaj mund të paraqitet në mënyrë elektronike me e-mail, nëpërmjet postës ose drejtpërdrejtë në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD).

Gjatë plotësimit të formularit të ankesës, kur paraqiteni personalisht pranë Zyrës së ILD, ju mund të asistoheni nga punonjësit e Sektorit të Ankesave.



Orari i dorëzimit të ankesave pranë ILD bëhet cdo ditë të javës, nga e hëna deri të premten, nga ora **09:00-14:00**.

“Angazhimi kryesor i institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është ushtrimi i funksioneve gjyqësore në Republikën e Shqipërisë në mënyrë sa më të pavarur, të paanshme dhe me integritet nëpërmjet një sistemi përgjegjshmërie dhe llogaridhënie.”

SEKTORI I ANKESAVE

Sektori i ankesave në ILD është përgjegjës për garantimin e të drejtës së informimit të qytetarëve dhe transparencën ndaj publikut. Ky sektor ndjek gjurmueshmërinë e ankesave në sistem dhe jep përgjigje për ankuesit, mbi fazën ku ndodhet ankesa e tyre.

Në kuadër të transparencës, për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas faqes dhe adresës zyrtare, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

STATISTIKA

Gjatë muajit **Mars**, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar 115 ankesa të cilat janë paraqitur nga qytetarë, organizata dhe institucione.

Konkretisht:

83 ankesa janë depozituar nga qytetarët;


2 ankesa nga organizata,

30 ankesa kanë ardhur nga institucione publike dhe jopublike.

21 telefonata me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre. **9 takime** me ankues, të cilët janë asistuar gjatë plotësimit të formularëve të ankesave në ambientet e ILD.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion, gjatë muajit Mars 2021.

Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projekt-vendimet përkatëse.



KLP PRANON KËRKESËN E ILD PËR SHKARKIMIN E NJË MAGJISTRATI NGA DETYRA

Këshilli i Lartë i Prokurorisë pranoi më 31 Mars 2021 kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për shkarkimin nga detyra të magjistratit B.M.

Pas verifikimit të nisur me iniciativën e tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë kishte urdhëruar korrikun e kaluar fillimin e hetimit disiplinor për magjistratin B.M, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë për shkelje

të rënda profesionale, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës.

Në kërkesën për procedim disiplinor para Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani kishte argumentuar, se në raport me faktet e provuara gjatë hetimit disiplinor ishte konstatuar mospërbushje e pajusti-



“Që në daljen e parë publike si Inspektor i Lartë i Drejtësisë më 8 Shkurt 2020 kam paraqitur si prioritet pune inspektimet tematike nëpër gjykata dhe prokurori për lirimet para kohe me kusht. Këtë e kemi bërë me burimet e kufizuara njerëzore që ka pasur ILD. Këtij inspektimi tematik i janë bashkuar edhe ankesat apo informacionet që kanë ardhur nga qytetarë apo institucione. Kjo është procedurë ligjore. ILD në ushtrimin e detyrës së vet nuk mund të jetë paragjykes ndaj ankesave që vijnë dhe ndaj të dhënave që publikojnë mediat. Është detyrë e ILD-së të verifikojë këto fakte”.

fikuar e funksioneve të magjistratit, gjatë dhe pas gjykimit, që çoi në lirimin para kohe me kusht të një të dënuari, si dhe mosrespektim i rëndë dhe i vazhduar i legjislacionit material dhe procedural penal.

Kuadri ligjor

- ◇ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- ◇ Ligj nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar
- ◇ Ligj nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”
- ◇ Vendim i Këshillit të Ministrave për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit.

Gjatë seancës në KLGJ

E.H. është magjistratja e dytë për të cilën KLGJ ka pranuar kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për shkarkim nga detyra, për shkelje të rënda disiplinore lidhur me lirimet para kohe me kusht dhe e treta magjistrate e shkarkuar nga KLGJ pas një hetimi disiplinor të ILD-së. Prej marrjes së detyrës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka ndarë shqetësimin publik për vendimmarrjet dhe veprimtarinë e institucioneve të tjera, lidhur me lirimet para kohe me kusht, duke përcaktuar si prioritet fillimin e inspektimit të ILD-së, pikërisht për këtë fenomen. Pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon verifikimi për vendimmarrje të ngjashme bazuar në procesin e inspektimit tematik në gjykatat e prokuroritë e vendit.

KLJ PRANON KËRKESËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË MAGJISTRATES E.H



Këshilli i Lartë Gjyqësor pranoi sot kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për masën disiplinore shkarkim nga detyra për magjistraten E.H., gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Kryetarja Naureda Llagami njoftoi vendimin,

sipas së cilit KLGJ, në mënyrë unanime vendosi shkarkimin nga detyra të magjistrates gjyqtare. Në seancën e paraqitjes së përfundimeve mbi hetimin e kryer, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani kishte argumentuar shkel-



jet disiplinore të magjistrates, si mospërbushje e pajustificuar e funksioneve gjatë gjykimit; veprime që kanë sjellë përfitim të padrejtë për palët, mosrespektim të rëndë e të vazhduar të legjislacionit material e procedural penal dhe nxjerrje të akteve (vendimeve) të paarsyetuara.

RAPORTIMI VJETOR I ILD

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani bëri raportimin para komisionit parlamentar Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut mbi punën e zyrës së ILD-së për vitin 2020. Në fjalën e tij para deputetëve, Inspektori i Lartë i Drejtësisë paraqiti rrugëtimin e Institucionit që, duke qenë krejt i ri, u ngrit nga e para, si me burime njerëzore ashtu edhe infrastrukturë.



Z. Metani tha se me vetëm një inspektor-magjistrat, të komanduar nga ish-KLD, zyra e Inspektorit të Lartë ka arritur të prodhojë rezultate që janë të prekshme, ndërsa evidentoj nevojën që ka institucioni që drejton për inspektorë magjistratë gjyqtarë për hetimin disiplinor.

NDIHMËS INSPEKTORËT TRAJNIM NGA EURALIUS PËR SISTEMIN DISIPLINOR



Ndihmës Inspektorët e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë zhvilluan një trajnim njëditor me ekspertë të Misionit Euralius V, mbi sistemin disiplinor në një këndvështrim të përgjithshëm. I organizuar në bashkëpunim me zyrën e



Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, gjatë trajnimit u trajtuan çështje të kuadrit të ri ligjor mbi përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve e prokurorëve dhe përputhshmërinë e sistemit të ri disiplinor me standardet ndërkombëtare.

Ky trajnim është në vijim të ciklit të trajnimeve të programuara nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në bashkëpunim me misionin EURALIUS V, në drejtim të forcimit të kapaciteteve. Cikli i trajnimeve ka nisur me Inspektorët magjistratë e jo magjistratë dhe do vi-

Gjatë Raportimit Vjetor 2020

“Tashmë Zyra e ILD,- tha Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka hartuar dhe miratuar një Plan Strategjik 2-vjeçar, të organizuar sipas 4 objektivave kryesore, konkretisht: fuqizimi dhe ushtrimi i veprmtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në mënyrë të pavarur, eficente dhe profesionale; zhvillimi i procesit të verifikimit, hetimit disiplinor dhe inspektimit në përputhje me parimet e procedimit disiplinor dhe standardet ndërkombëtare; pjesëmarrje aktive në proceset e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional; si dhe rritja e transparencës dhe aksesit të publikut në Institucionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

“Raportimi i parë në Kuvend, para komisionit të ligjeve për punën e ILD-së për vitin 2020. Garantova deputetët, se Inspektori i Lartë i Drejtësisë pavarësisht vështirësive, do vijojë punën me shumë përkushtim për të adresuar çdo shqetësim të qytetarëve”
– shkruan Inspektori në llogarinë zyrtare në Twitter.

Kliko për të ndjekur raportimin e plotë.

Mars 2021

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë


© ILD



KONTAKT ILD

WEB: ild.al
EMAIL: info@ild.al
ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina nr.13
Tiranë, Shqipëri



 [Inspektori i Larte i Drejtesise Artur Metani @ILD_Albania](https://twitter.com/ILD_Albania)  [Inspektori i Lartë i Drejtësisë](https://www.youtube.com/Inspektori%20i%20Lart%C3%AB%20i%20Drejt%C3%ABsis%C3%AB)



Spot prezantues ILD
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com/spot)

[Kliko për të ndjekur spotin prezantues të ILD](#)